



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 39 / Prot
5

Tiranë, më 27. 2.2017

VENDIM

Nr. 37, datë 27. 2.2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr.44/2015 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Vesper" sh.p.k. Tiranë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr.05 datë 11.01.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 13.01.2017 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit "Vesper" sh.p.k. Tiranë, me objekt:

- Zbatimi i Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "Vesper" sh.p.k. Tiranë.

Në datë 13.01.2017, grupi i kontrollit komunikoi me përfaqësuesit e kontrolluesit, mbi detyrimin për zbatim të Urdhrit Nr.05 datë 11.01.2017 të Komisionerit.

"Vesper" sh.p.k. Tiranë, sipas ekstraktit nga regjistri tregtar për të dhënat e subjektit, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt të aktivitetit: Shërbime Call Center dhe Contact Center, për klientë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë etj. Data e themelimit është 17.04.2014, me NIPT L41618006M.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi "Vesper" sh.p.k. nuk e ka kryer "Njoftimin" pranë Zyrës së Komisionerit, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij. Verifikimi është bërë në Regjistrin Elektronik të Kontrolluesve i cili administrohet nga K.D.I.M.D.P.

Në momentin e ushtrimit të kontrollit administrativ, përfaqësuesi i kontrolluesit i ka paraqitur grupit të inspektimit formularin e Njoftimit bashkëlidhur "*Dëftesa për pranimin e objekteve postare*" datë 13.01.2017, ku konfirmohet dërgimi i Formularit të Njoftimit në rrugë postare.

2. Kontrolluesi disponon rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale si dhe rregullore për sistemin e kontrollit të aksesit nëpërmjet gjurmëve të gishtave, përpunimin e të dhënave në mënyrë mekanike, për përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV), për marrjen e të dhënave personale në mënyrë mekanike dhe të shenjave të gishtave.
3. Kontrolluesi ka pajisur punëmarrësit me Deklaratë Konfidencialiteti.
4. Kontrolluesi mbikëqyr ambientet e brendshme nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV). Në hyrje të ambienteve janë vendosur tabela informuese mbi prezencën e këtij sistemi.
5. Kontrolluesi nuk ka marrë pëlqimin e 50 punonjësve për monitorimin e tyre gjatë orarit të punës, nëpërmjet sistemit të kamerave vëzhguese (CCTV).

Konstatimi sipas pikës 1 të këtij procesverbali përbën shkelje administrative të nenit 21 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Konstatimi sipas pikës 5 të këtij proces verbali përbën shkelje administrative të nenit 5, 6 Kreu II i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, Udhëzimit Nr.3 datë 05.03.2010 të Komisionerit, mbi "*Përpunimin e të Dhënave Personale me Sistemin e Video Survejimit në Ndërtesa dhe Mjedise të tjera*", Udhëzimit Nr.11 datë 08.09.2011 të Komisionerit, mbi "*Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat*".

Si prova i bashkëngjiten këtij procesverbali këto dokumente:

1. Autorizim përfaqësimi.
2. Formular Njoftimi bashkëlidhur "*Dëftesa për pranimin e objekteve postare*" datë 13.01.2017.
3. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
4. Rregullore për marrjen e të dhënave personale të shenjave të gishtave dhe masave tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale.
5. Rregullore për marrjen e të dhënave personale nëpërmjet video-survejimit dhe masave tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale.
6. Rregullore për marrjen e të dhënave personale financiare dhe jo financiare masave tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale.
7. Rregullore për marrjen e të dhënave personale në mënyrë mekanike dhe të shenjave të gishtave dhe masave tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale.

8. Deklaratë konfidencialiteti për punëmarrësit.
9. Procedura për fshirjen/çregjistrimin e punonjësve të larguar, nga sistemi i kontrollit të aksesit nëpërmjet gjurmëve të gishtave.
10. Printime nga sistemi i video-vëzhgimit (CCTV), ambientet e mbikëqyrura, tabelat informuese dhe koha e ruajtjes.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" datë 30.04.2015, përpara marrjes së aktit final, kontrolluesi "Vesper" sh.p.k. Tiranë është njoftuar zyrtarisht për pjesëmarrje në seancën dëgjimore që do zhvillohej në datë 08.02.2017, për të ushtruar të drejtën e tij për tu dëgjuar. Përfaqësuesit e kontrolluesit paraqitën pretendimet si më poshtë:

"Në lidhje me shkeljen e parë administrative sqarojmë se, shoqëria "Vesper" sh.p.k. e ka njoftuar Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nëpërmjet Formularit të Njoftimit, provuar nëpërmjet mandatit të Postës Shqiptare "Dëftesa për pranimin e objekteve postare, datë 13.01.2017, ora 6:58:37 PM", kur akti i themelimit të këtij kontrolluesi daton në 17.04.2014.

Në lidhje me shkeljen e dytë administrative, pretendojmë se, arsyet përse shoqëria "Vesper", sh.p.k. nuk e ka marrë pëlqimin e punëmarrësve për monitorimin e tyre nëpërmjet sistemit të video-survejit (CCTV) janë:

- 1) Në gërmën "c" pika 3, të Udhëzimit Nr. 3 datë 05.03.2010 mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", citohet se: "3. Përpunimi i të dhënave personale me anë të një sistemi video survejit është i ligjshëm: c) pa pëlqimin e subjektit por gjithnjë duke respektuar kriteret e përcaktuara në nenin 6 të ligjit "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
- 2) Ia vlen të theksojmë se punonjësi është i vetëdijshëm dhe e shpreh vullnetin e tij të lirë për të filluar marrëdhëniet e tij juridike të punës pranë shoqërisë "Vesper" me NIPT L41618006M, ku është vetë punonjësi që shpreh dhe vullnetin e tij të lirë që të dhënat personale të tij, të përdoren për interesat legjitime të punëdhënësit të tij.

Gjithashtu, në ambientet e shoqërisë "Vesper" sh.p.k, janë të ekspozuara në mënyrë të qartë dhe të dukshme, tabelat informuese për praninë e kamerave që survejojnë këto ambiente (sipas modelit të përcaktuar nga Udhëzimi Nr.3 datë 05.03.2010 mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejit në ndërtesa dhe mjedise të tjera").

Nisur nga kjo, punonjësit janë në dijeni të fakteve të mësipërme dhe përderisa këta punonjës nuk dëshirojnë të largohen nga puna, për arsye se nuk pëlqejnë të monitorohen nga video-survejimi (CCTV), është logjike dhe e arsyeshme të mendojmë se punonjësit e kanë dhënë në mënyrë të heshtur, pëlqimin e tyre që të monitorohen nga video-survejimi (CCTV).

- 3) Arsyeya e tretë, që pse ne pretendojmë se marrja e pëlqimit të punëmarrësve për monitorimin e tyre, nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (CCTV), nuk ka qenë i nevojshëm, është në mbështetje të gërmës "ç", të pikës 1, të nenit 6 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, në të cilin citohet se: "Të dhënat personale përpunohen vetëm, për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit". Detyrimi ligjor për shoqërinë "Vesper" shpk, përcaktohet pikërisht në gërmën "b" të nenit 4 të Ligjit Nr. 19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike" miratuar në datën 22.09.2016, në të cilin citohet se: "Kategoritë e subjekteve, që detyrohen të marrin masa shtesë sigurie pas vlerësimit të analizës së rrezikut të bërë nga Policia e Shtetit janë subjektet që kanë mbi 50 punonjës dhe/ose frekuentues, të cilët, në mënyrë të vazhdueshme, akomodohen apo frekuentojnë në të njëjtën kohë një mjedis të hapur ose të mbyllur", dhe në gërmën "ç" të nenit 4 të Ligjit Nr.19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike", datë 22.09.2016, citohet se: subjektet që kanë aktivitet ekonomik, xhiroja vjetore e së cilës është mbi 10 milionë lekë;

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë sugjerimet e institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shoqëria "Vesper" sh.p.k, ka modifikuar edhe Deklaratën (bashkëngjitur këtyre Pretendimeve), në të cilën punonjësi që fillon punë për herë të parë pranë kësaj shoqërie, duke shprehur vullnetin e tij të lirë, jep pëlqimin për monitorimin e tij nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (CCTV)".

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi pretendimet e mësipërme shprehet:

Në lidhje me pikën 1 të pretendimeve:

Detyrimi për njoftim, në regjistrin e kontrolluesve pranë Zyrës së Komisionerit, fillon që në fillesat e aktivitetit të një kompanie, e cila në këndvështrim të ligjit është kontrollues.

Zyra e Komisionerit, për gati tre vjet nuk ka pasur informacion mbi ekzistencën e këtij kontrolluesi, gamën e të dhënave që ai përpunon, mënyrën se si i përpunon dhe mbron ato, qëllimin, kategoritë, aktet në funksion të mbrojtjes së të dhënave etj. Kjo përbën shkelje, pasi për këtë periudhë tre vjeçare, ka shmangur monitorimin e Zyrë së Komisionerit, si një tagër i tij parashikuar në nenin 31, pika 2 e Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe duke rënë ndesh gjithashtu me nenin 21, pika 1 e këtij ligji.

Në lidhje me pikën 2 të pretendimeve:

2.1.Duke ju referuar bazës ligjore mbi të cilën kontrolluesi ka ngritur pretendimin, konkludoj se, kontrolluesi gjendet në kushtet e pikës 3, gërma "b", sipas së cilës citohet:

"3. Përpunimi i të dhënave personale me anë të një sistemi video survejjimit është i ligjshëm:

b) me pëlqimin e subjektit të të dhënave, por praktikisht kjo është e mundshme vetëm në raste shumë të kufizuara, atëherë kur identifikimi i një grupi personash që janë brenda zonës së kamerës bëhet në mënyrë të qartë."

Theksojmë se gërma "c", e cila konsiston në mos marrjen e pëlqimit, konsiston në survejimin e zonave publike të cilat mbikëqyren me kamera dhe grupet e personave nuk janë të identifikuar në forma të tjera, si: të dhënat personale që përfshijnë gjeneralitetet, apo numra telefoni, adresa elektronike, gjurmë gishtash, apo dhe të dhëna të tjera të cilat kontrolluesi i disponon për punëmarrësit e tij, pra grupi i punëmarrësve është i identifikuar.

Për sa i përket pretendimit se: neni 6 i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, pika 1, gërma "c" dhe "dh" citohet: "1. Të dhënat personale përpunohen vetëm: c) për të mbrojtur interesat jetike të subjektit të të dhënave; dh) nëse është thelbësor për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të kontrolluesit, marrësit apo personave të tjerë të interesuar. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale nuk mund të jetë në kundërshtim të hapur me të drejtën e subjektit të të dhënave për mbrojtjen e jetës personale dhe private.", theksoj se, gërma "c" dhe në këtë rast nuk është me vend, pasi konsiston në rastet e vëzhgimit në ambientet që përfshijnë aktivitetet e aeroporteve, pikave kufitare, rrugëve etj. Ndërsa gërma "dh", pika 1 e nenit 6 nuk përjashton kurrësi mundësinë që, për interesa legjitime të kontrolluesit të mos merret pëlqimi, ekskluzivisht për vëzhgimin me kamera survejuese, por në parim për të dhënat që çdo kontrolluesi i duhet të sigurojë për të ekzekutuar një marrëdhënie juridike me subjektet e të dhënave.

Gjithashtu, vlen të kujtoj se kontrolluesi ka dy praktika të ndryshme brenda zbatimit të fushës së mbrojtjes së të dhënave personale, e cila konsiston në marrjen e pëlqimit nga ana e punëmarrësve për përdorimin e të dhënave të tyre për gjurmët e gishtërinjve, dhe nuk ka marrë pëlqimin për vëzhgimin me kamerat survejuese.

Në lidhje me pikën 2.2 të pretendimeve:

Zyra e Komisionerit në lidhje me pretendimet e kësaj pike, sjell në vëmendjen tuaj, se ajo çka pretendohet nga përfaqësuesit e "Vesper" sh.p.k. Tiranë se: "është logjike dhe e arsyeshme të mendojmë se punonjësit e kanë dhënë në mënyrë të heshtur, pëlqimin e tyre që të monitorohen nga video-survejimi (CCTV)", nuk është e ligjshme, pasi përkufizimi i mekanizmit të "Pëlqimit", sipas nenit 3, pika 24, i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, citon:

"24. "Pëlqimi i subjekteve të të dhënave" është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij".

Në lidhje me pikën 2.3 të pretendimeve:

Zyra e Komisionerit në lidhje me pretendimet e kësaj pike, sjell në vëmendjen tuaj se trajtimi i legjitimitetit të mos marrjes së pëlqimit sipas: gërmës "b" të nenit 4 të Ligjit Nr.19/2016 datë 22.09.2016 "Për masat shitesë të sigurisë publike", i cili citon: "Kategoritë e subjekteve, që detyrohen të marrin masa shitesë sigurie pas vlerësimit të analizës së rrezikut të bërë nga Policia e Shtetit janë subjektet që kanë mbi 50 punonjës dhe/ose frekuentues, të cilët, në mënyrë të vazhdueshme, akomodohen apo frekuentojnë në të njëjtën kohë një mjedis të hapur ose të mbyllur"

dhe në gërmën “ç” të nenit 4 të Ligjit Nr. 19/2016 “Për masat shitesë të sigurisë publike”, citohet: “subjektet që kanë aktivitet ekonomik, xhiroja vjetore e së cilës është mbi 10 milionë lekë”, nuk e legjitimon mos marrjen e pëlqimit.

Së pari: Nga kontrolluesi “Vesper” sh.p.k. Tiranë, nuk u vu në dispozicion, analiza e riskut vlerësuar nga Policia e Shtetit, ose të paktën një procedurë e filluar nga kontrolluesi për këtë qëllim.

Së dyti: Kontrolluesi “Vesper” sh.p.k. Tiranë, nuk është në kushtet e gërmës “ç”, “dh” apo gërmës “e” të nenit 4 të Ligjit Nr. 19/2016 datë 22.09.2016 “Për masat shitesë të sigurisë publike”.

Së treti: Neni 14 (Përpunimi i të dhënave personale), i Ligjit Nr.19/2016 datë 22.09.2016 “Për masat shitesë të sigurisë publike”, parashikon se:

“Përpunimi i të dhënave personale të përfituara nga sistemet e sigurisë, të parashikuara në këtë ligj, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Zyra e Komisionerit, vlerëson faktin që, kontrolluesi “Vesper” sh.p.k. Tiranë, ka siguruar pëlqimin e punëmarrësve mbi vëzhgimin e tyre me kamera survejuese, gjatë kohës së punës, dhe ka kryer detyrimin për njoftim, pikërisht në datën kur ka filluar inspektimi administrativ, duke reaguar në kohë reale.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit konkludon se, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika 1, gërma “a” dhe “d”, të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përbëjnë “kundërvajtje administrative”, e cila sanksionohet me gjobë si më poshtë:

“1.Rast e përpunimit të të dhënave në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji kur nuk përbëjnë kundërvajtje penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen më gjobë, si më poshtë:

- a) Kontrolluesit që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;”.*
- d) kontrolluesit që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;”.*

Kontrolluesi “Vesper” sh.p.k. Tiranë, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se, shkeljet e konstatuara konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, kryesisht për kategorinë “punëmarrës”.

Gjithashtu, në zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5 dhe 6, Kreu II, neni 39 pika 1, gërmat "a" dhe "d", neni 39, pika 2 e Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të Komisionerit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Vesper" sh.p.k. Tiranë, me gjobë në vlerën **50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 5 dhe 6, kreu II të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "Vesper" sh.p.k. Tiranë, me gjobë në vlerën **20.000 (njëzet mijë) lekë** për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 27.2 2017.

